VENDIM
Nr.218, datë 25.5.1997

PËR MIRATIMIN E VENDOSJES NË SHQIPËRI TË EKIPEVE TË NDIHMËS LOGJISTIKE PËR USHTRINË

Në bazë të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuesë", neni 36, pika 2, me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Mbrojtjes, për të përballuar nevojat emergjente dhe afatgjata të mbajtjes së ushtrisë, të marrë dhe të administrojë ndihma logjistike nga ushtritë e vendeve të tjera.

2. Të miratojë vendosjen e ekipeve të përkohshme për administrimin e ndihmave nga Italia, Turqia e Greqia, me përbërje 3-5 veta. Misioni i këtyre ekipeve të jetë koordinimi i pritjes dhe i shpërndarjes së ndihmave logjistike që këto vende kanë vënë në dispozicion.

3. Ministria e Mbrojtjes të këmbejë letrat me ministritë përkatëse të secilit vend, ku të përcaktohet statusi e misioni i këtyre ekipeve, koha e livrimit të ndihmave dhe koha e qëndrimit të ekipeve. Për çdo rast afati të mos kalojë 6 muaj, me të drejtë shtyrjeje edhe për 6 muaj të tjerë. Misioni i tyre të jetë mbajtja e lidhjeve dhe koordinimi për sjelljen dhe shpërndarjen e ndihmave.

Shpenzimet, e të gjitha llojeve, për sjelljen dhe akomodimin e ekipeve të ndihmës në Shqipëri të përballohen nga vendi dërgues.

4. Ministria e Mbrojtjes të ndjekë zbatimin e këtij vendimi dhe të marrë masa për pritjen e administrimin e ndihmave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino